



rrethanave të faktit, duke arritur në konkluzione dhe zbatim të gabuar të ligjit penal material. Kjo çështje duhet kthyer për rishqyrtim në gjykatën e apelit, si gjykatë fakti dhe ligji. Kolegji vlerëson se ky kthim diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve dhe provave/akteve të marra në këtë proces penal, të cilat duhen verifikuar në raport me të drejtën/ligjin e zbatueshëm në rastin konfliktet. Në rigjykimin e çështjes, gjykata e apelit duhet të ketë në konsideratë konkluzionet dhe analizën e Kolegjit në këtë vendim njëstës. Referuar akuzës së atribtuar të gjyqtarve, "Trafikimi i personave të rritur", parashikuar nga neni 110/a i KP-së, si dhe në referim të neneve 74 dhe 75/a të KPP-së, kjo çështje aktualisht i përket juridiksionit të përgjithshëm (gjykatave të tregut gjyqësor), ndaj çështja duhet dërguar për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

#### PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 74, 75/a, 438 dhe 441, pika 1, shkronja "c", të Kodit të Procedurës Penale,

#### VENDOSI:

Prishjen e vendimit nr. 54, datë 16.5.2016, të (ish-) Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, si gjykata që ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje penale.

Ky vendim është njëstës dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 27.7.2022

**Kryesues:** Ilir Panda

**Anëtarë:** Medi Bici, Sokol Binaj, Albana Boksi,  
Sandër Simoni

#### KËRKESË

Nr. 202/10, datë 21.12.2022

#### PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rivitalizimi urban i Bulevardit Maliq-Drithas", me vlerë totale paraprake të shpronësimit 140,730 (njëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Maliq.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

- Për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë" është bërë bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për imitimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehin nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Maliq, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 140,730 (njëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM  
TË SHPRONËSIMEVE

Egra Ibrahim

